



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1082 / Prot.  
13

Gjirokastrë, më 08 / 09 / 2020

KODI I ETIKËS  
I  
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 26, datë 09.09.2020



## PREAMBULA

1. Të vetëdijshëm për funksionin arsimor, kërkimor dhe social të një institucioni të arsimit të lartë, Universiteti “Eqrem Çabej” (më poshtë Ugj), njeh parimet themelore dhe vlerat etike të pranuar nga komuniteti shkencor ndërkombëtar në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe të gjitha veprimtaritë e tjera universitare.
2. Ugj mbështet përgjegjësinë dhe angazhimin institucional dhe individual të komunitetit akademik. Ai e konsideron etikën dhe sjelljen e përgjegjshme si vlera themelore për ndjekjen e qëllimeve institucionale, për nxitjen e meritës dhe përsosmërisë, për shkëmbime me komunitetin shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, në krijimin e një mjedisi profesional që është i hapur ndaj dialogut, marrëdhënieve ndërpersonale dhe mbrojtjes së vlerave individuale. 3. Përmes këtij dokumenti, në vijim referuar si “Kodi”, Ugj i kërkon personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentëve, secili brenda rolit dhe funksionit institucional, të përmbushë dhe të promovojë:
  - a. parimet themelore të njohura nga Konventa dhe Karta e të Drejtave të Njeriut; parimet etike të Magna Charta Universitatum, të referuara në udhëzimet ndërkombëtare për Kodin Institucional të Etikës në Arsimin e Lartë; parimet e Kodit Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor dhe të Kartës Evropiane të të Drejtave të Studentëve;
  - b. ligjet kushtetuese dhe dispozitat normative në lidhje me transparencën dhe shpërndarjen e informacionit nga administrata publike; parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe paligjshmërisë;

## PJESA I

### PARIMET ETIKE TË UNIVERSITETIT

#### KREU I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Baza ligjore

Ky Kod është nxjerrë në zbatim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit nr.9131 datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 7961 datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e Informimit”, Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe Statutit dhe Rregullores së Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me fushën e veprimt të këtij kodi.



## **Neni 2**

### **Qëllimi**

Kodi synon të ruajë vlerat themelore të komunitetit universitar, të sigurojë njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive personale si dhe të garantojë detyrat dhe përgjegjësitë etike dhe sociale ndaj institucionit. Ai përcakton rregullat e sjelljes së komunitetit dhe të të gjithë personave që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë gëzojnë marrëdhënie me Ugj.

Kodi rregullon marrëdhëniet e brendshme ndërmjet anëtarëve të komunitetit universitar dhe marrëdhëniet me të gjithë aktorët e jashtëm, me qëllim shmangien e të gjitha formave të diskriminimit dhe abuzimit, qeverisjen e konfliktit të interesit, përmirësimin e klimës organizative dhe mjedisit të punës, nxitjen e sjelljes së virtytshme dhe parandalimin e sjelljeve joetike ose të paligjshme.

Parimet e përcaktuara në Preambul do të udhëheqin interpretimin e secilës dispozitë të Kodit dhe do të merren për bazë në shpjegimin e të gjitha çështjeve etike të lidhura me veprimtarinë e universitetit

Ky kod sanksionon dhe organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës.

## **Neni 3**

### **Fusha e veprimit**

Kodi i Etikës është i detyrueshëm për zbatim në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në Rektorat, në njësitë kryesore, bazë dhe ato ndihmëse që janë pjesë e këtij universiteti. Të gjithë punonjësit të cilët janë në marrëdhënie pune, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës së punës, personel akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e këtij Kodi. Gjithashtu, këto dispozita janë të detyrueshme edhe për studentët që ndjekin programe studimi në Ugj.

## **KREU II**

### **INTEGRITETI AKADEMIK DHE SJELLJA ETIKE NË MËSIMDHËNIE DHE KËRKIM SHKENCOR**

## **Neni 4**

### **Liria, autonomia dhe cilësia në mësimdhënie dhe kërkim**

1. Universiteti njeh autonominë e kërkimit shkencor dhe lirinë e mësimdhënies si vlera themelore për krijimin dhe transmetimin e dijeve. Ai merr përsipër krijimin e një mjedisi shkencor dhe institucional të përshtatshëm për të nxitur të mësuarit gjatë gjithë jetës, shkëmbimet midis komunitetit shkencor dhe akademik kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilat përbëjnë kushte për rritjen dhe sigurimin e cilësisë.
2. Universiteti promovon veprimtari cilësore me rëndësi për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai garanton zhvillimin e programeve mësimore me qëllim forcimin dhe mbrojtjen e vlerave etike dhe integritetin akademik; nxit diskutimin dhe debatin mbi çështjet etike me interes për komunitetin.



3. Përbushja e saktë e detyrave institucionale nga të gjithë anëtarët e komunitetit universitar mbizotëron mbi të gjitha veprimtaritë e tjera profesionale jashtëinstitucionale, sado të ligjshme të jenë ato.

### Neni 5

#### Veprimtaritë mësimore dhe marrëdhëniet me studentët

1. Studentët janë anëtarë të Universitetit, për të cilët hartohen dhe zbatohen veprimtaritë kryesore, duke nxitur nivel të lartë kulturor dhe profesional në mësimdhënie, si dhe duke marrë parasysh nevojat e shprehura nga shoqëria në tërësi.
2. Marrëdhëniet ndërmjet stafit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentëve bazohen në parimet e integritetit, besimit, bashkëpunimit dhe korrektësisë reciproke, respektit, mundësive të barabarta, ndershmërisë dhe mosdiskriminimit.
3. Në marrëdhëniet me studentët, Ugj realizon:
  - a. Këshillim efektiv me qëllim që të:
    - i. mbështeten zgjedhjet në lidhje me karrierën universitare, lehtësimin e procedurave hyrëse në programet e studimit të ofruara në Ugj dhe plotësimin e çdo kriteri shtesë specifik (përcaktuar në udhëzimet hyrëse);
    - ii. përbushen procedurat e aplikimit në programe të financuara nga BE apo organizata të tjera ndërkombëtare;
    - iii. krijohen mundësitë për hyrjen në tregun e punës, nëpërmjet shërbimeve udhëzuese (këshillimi i karrierës);
  - b. Organizimin e veprimtarive mësimore, provimeve dhe të lëndëve sipas kritereve të transparencës dhe njohjes së meritës;
  - c. Të drejtën e studentëve për të përdorur hapësirat e përbashkëta për socializim dhe debat shkencor;
  - d. Cilësinë e lartë të shërbimeve që mbështesin mësimdhënien dhe të drejtën për arsimin e lartë;
  - e. Krijimin e lehtësirave infrastrukture për përdorimin e plotë të shërbimeve nga studentët me aftësi të kufizuara;
  - f. Një procedurë transparente për matjen e mendimeve të studentëve në lidhje me përmbajtjen dhe organizimin e programeve të studimit, të performancës së personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ.

### Neni 6

#### Cilësia dhe transparenca e veprimtarive kërkimore-shkencore

1. Komunitetet akademike dhe shkencore kanë përgjegjësinë të zhvillojnë dhe të zbatojnë parimet, normat, standardet dhe kriteret e etikes së kërkimit në Ugj dhe në disiplinat shkencore përkatëse, si dhe t'u përgjigjen në mënyrën e duhur rreziqeve ose shkeljeve të integritetit.
2. Në shpërndarjen e fondeve të përcaktuara për financimin e kërkimit, Universiteti merr parasysh nevojat dhe karakterin specifik të çdo fushe, si dhe kontributet individuale dhe të



grupit në fushën shkencore.

3. Ugj merr përsipër të garantojë transmetimin e plotë të rezultateve të kërkimit shkencor dhe promovon qasjen në metodologjinë e ndjekur, duke përdorur të gjitha mjetet e përshtatshme, në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Kodi.

## Neni 7

### **Përdorimi dhe ruajtja e rezultateve të veprimtarive kërkimore-shkencore**

1. Kërkuesit si dhe strukturat përgjegjëse në Ugj mundësojnë ruajtjen e sigurt të të dhënave e të materialeve kërkimore të Ugj-së, përfshirë ato të pabotuara, për një periudhë kohore të arsyeshme, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren “Për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore e Botuese”.
2. Kërkuesit, si dhe strukturat përgjegjëse në Ugj sigurojnë që qasja në të dhënat të jetë e lirë sa më shumë të jete e mundur: e gjeshme, e arritshme, ndërvepruese, transparente, e ripërdorshme. Qasja në të dhënat mund të kufizohet aq sa e vlerësojnë të nevojshme këto struktura, me qëllim që të ruajnë të dhënat mbi çështje të sigurisë së vendit ose nëse kërkohet nga financuesit e kërkimit.
3. Kërkuesit, Ugj dhe strukturat vartëse kërkimore prodhojnë të dhëna dhe produkte legjitime dhe të mundshme për t'u cituar, në bazë të standardeve të citimit të parashikuara nga Shoqata Amerikane e Psikologjisë.
4. Kërkuesit, Ugj dhe strukturat vartëse kërkimore sigurojnë që çdo kontratë a marrëveshje për publikimin ose përdorimin e rezultateve të kërkimit, të respektojë pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.
5. Anëtarët e komunitetit universitar duhet të respektojnë normat që kanë të bëjnë me pronën intelektuale dhe plagjiaturën. Plagjiatura është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve si të vetat, pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale. Plagjiatura mund të jetë e qëllimshme ose efekt i një qëndrimi jo të duhur.

## KREU III

### **MERITA, DREJTËSIA, MOSDISKRIMINIMI DHE MUNDËSITË E BARABARTA**

## Neni 8

### **Njohja e meritës**

1. Universiteti njeh dhe promovon meritën individuale si një kriter thelbësor për zhvillim personal dhe profesional. Përsa i përket punësimit dhe përparimit në karrierë, merita përbën një nga kushtet e vlerësimit dhe përzgjedhjes, sipas aftësisë, njohurisë dhe përvojës.
2. Merita është kriteri me anën e të cilit studentët vlerësohen në programet e tyre të studimit dhe shpërblehen në format dhe mënyrat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi dhe Rregullores së Ugj.
3. Ugj mbështet nismat e stafit të tij për të rritur kompetencat profesionale dhe përvojat



individuale në dobi të të gjithë komunitetit universitar. Ai miraton stafin e brendshëm dhe të jashtëm dhe procedurat e vlerësimit të tij bazuar në objektiva të përcaktuara qartë, me qëllim promovimin e përmirësimit të performancës organizative dhe individuale.

### **Neni 9** **Ndalimi i diskriminimit**

1. Të gjithë anëtarët e universitetit kanë të drejtën të trajtohen në mënyrë të barabartë, me mirëkuptim, respekt dhe nderim duke mos iu nënshtruar në asnjë moment diskriminimit, direkt apo indirekt, për shkak të një apo më shumë faktorëve, duke përfshirë fenë, gjininë, orientimin seksual, ndërgjegjen dhe bindjet personale, aspektin fizik dhe ngjyrën, gjuhën, origjinën etnike apo shoqërore, nënshitetësinë, kushtet personale dhe të shëndetit, shtatzaninë, zgjedhjet familjare, moshën etj.
2. Përbën diskriminim të drejtpërdrejtë kur, në bazë të cilitdo prej motiveve të përcaktuara dhe të sanksionuara në këtë kod dhe në legjislacionin në fuqi, një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme nga sa është trajtuar apo do trajtohej një tjetër në një situatë të ngjashme.
3. “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në legjislacionin në fuqi, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.
4. Ugj kundërshton çdo formë të paragjykimit të padrejtë shoqëror, çdo ngacmim apo shqetësim të ardhur për shkak të cilitdo prej motiveve të sanksionuara në këtë kod dhe në legjislacionin në fuqi, çdo praktikë fyese apo poshtëruese, çdo ide të epërsisë morale të një grupi kundrejt një tjetri.
4. Është detyrë e universitetit dhe anëtarëve të tij të inkurajojë iniciativat e drejtuara në mbrojtjen dhe vlerësimin e kategorive të pafavorizuara, ndryshimin individual dhe kulturor

### **Neni 10** **Abuzimet dhe ngacmimet seksuale**

1. Abuzimi dhe ngacmimi seksual përkufizohen si kërkesa për favore seksuale, dhe/ose propozime të padëshirueshme të shërbimeve me përmbajtje seksuale, dhe/ose sjellje apo shprehje verbale fyese që kanë për objekt sferën personale të seksualitetit drejtuar një personi, duke u nisur nga gjinia apo orientimi i tij seksual.
2. Ugj nuk toleron abuzime apo ngacmime të natyrës seksuale, të kuptuara këto si sjellje diskriminuese që lëndojnë dinjitetin njerëzor dhe u siguron viktimave mbrojtjen e duhur, të lirë nga paragjykimi.
3. Ekzistenca e një pozicioni jo të barabartë ndërmjet atij që ngacmon dhe viktimës përbën element rëndues të abuzimit apo ngacmimit seksual, për sa mund të verifikohet se:
  - a. pranimi nga ana e viktimës është një kusht për regjistrimin, punësimin apo emërimin në



- universitet;
- b. pranimi ose refuzimi përbëjnë element të vlerësimit që ka rëndësi për punësimin, emërimin, ngjitjen në karrierë apo të tjera vendime që kanë të bëjnë me viktimitë;
  - c. qëllimi ose efekti i sjelljes është krijimi i një klime armiqësore, me qëllim që të zvogëlohet rendimenti normal i punës nga ana e viktimitë.

### **Neni 11** **Nepotizmi dhe favorizmi**

1. Kemi të bëjmë me nepotizëm apo favorizëm, kur një pjesëtar i personelit akademik, ndihmësakademik apo administrativ, direkt ose indirekt, përdor autoritetin e tij apo aftësinë bindëse për të dhënë përfitime, për të favorizuar detyra apo emëtime, për të ndikuar mbi përfundimet e konkurseve apo në procedurat e përzgjedhjes që kanë të bëjnë, në veçanti, por jo ekskluzivisht, me fazën fillestare të formimit në karrierën universitare apo në dhënien përparësi të fëmijëve, familiarëve apo personave që bashkëjetojnë me ta.
2. Nepotizmi përfshin gjithashtu të gjitha format e favorizimeve ndaj studentëve dhe bashkëpunëtorëve në pozita vartëse, ku kjo kuptohet si sjellje e pajustificuar dhe arbitrare që bie në kundërshtim me rregullat e mosdiskriminimit dhe njohjes së meritës dhe mund të dëmtojë prestigjin e Universitetit.
3. Ugj dënon nepotizmin dhe favorizmin, të cilët bien në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, me vlerësimin e meritave individuale, profesionalizmin dhe lirinë akademike, me ligjshmërinë, paanësinë dhe transparencën dhe u kërkon stafit akademik dhe çdo anëtar tjetër të universitetit të përmbahet nga të tilla praktika dhe t'i referojnë Këshillit të Etikës rastet e sjelljeve të dyshimta.

### **Neni 12** **Abuzimi me pozicionin**

1. Asnjë anëtar i universitetit nuk i lejohet të përdorë, direkt apo indirekt, autoritetin e pozicionit të vet akademik apo të zyrës së tij me qëllim që të detyrojë anëtarë të tjerë të universitetit të kryejnë shërbime në favor të tij, gjithmonë nëse kjo nuk është parashikuar si një detyrim juridik i të dytëve.
2. Shpërdorimi i pozitës i referohet sjelljes që synon marrjen e shërbimeve nga palë të tjera, shërbime të cilat, megjithëse nuk janë të ndaluara shprehimisht nga ligjet në fuqi, bien në kundërshtim me parimet e këtij Kodi.

### **Neni 13** **Dhuratat dhe favore**

1. Personeli i Ugj-së nuk duhet të kërkojë ose të pranojë, dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitim tjetër, apo/dhe shmangie të humbjeve të mundshme si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie, që ndikojnë ose mund të ndikojnë në të ardhmen në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose mund të jenë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.



2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastin e ftesave zyrtare, të mikëpritjes tradicionale, të dhuratave me vlerë simbolike ose tradicionale, të mirësjelljes, të cilat nuk krijojnë dyshime mbi paanshmërinë e punonjësit.
3. Në rast dyshimi mbi paanshmërinë e përfitimeve, punonjësi i Ugj-së këshillohet me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit.
4. Në qoftë se punonjësit i ofrohet një avantazh i padrejtë, ai duhet:
  - a. ta refuzojë, pa pasur nevojë ta pranojë atë për ta përdorur si provë;
  - b. të përpiqet që ta identifikojë personin që i bën ofertën;
  - c. të raportojë përpjekjen, sa më shpejt që të jetë e mundur, tek eprori i tij ose tek Drejtoria Ndihmës Akademike-Administrative.

## **KREU IV PËRGJEGJËSIA, PAVARËSIA DHE KONFLIKTI I INTERESAVE**

### **Neni 14**

#### **Përgjegjësitë dhe konflikti i interesave**

1. Në përputhje me parimet e veta themelore, të lirisë akademike dhe autonomisë, Ugj është institucion i lirë dhe i pavarur nga të gjitha format dhe kushtëzimet e interesave të jashtme. Ugj kërkon që anëtarët e saj, në kryerjen e detyrave të tyre institucionale, të respektojnë parimet e korrektségisë dhe paanësisë, duke punuar para së gjithash në interes të Institucionit duke shmangur situatat e konfliktit të interesave.
2. Ka konflikt interesi, kur interesi vetjak i një anëtari të universitetit, me përjashtim të studentit, bie në kundërshtim realisht apo potencialisht me interesin, jo vetëm ekonomik, të universitetit.
3. Orientimi i studentëve për të blerë mallra ose shërbime tek një anëtar i stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ që i ofron ato, përbën konflikt interesi.
4. Kur emëron përfaqësuesit e tij në organe, kompani dhe organizata të tjera, Universiteti merr përsipër të shmangë të gjitha konfliktet e mundshme dhe të veprojë para së gjithash në interes të Institucionit.
5. Anëtari i universitetit, që në një veprim apo rrethanë të caktuar ka interes në konflikt me ato të universitetit, duhet të njoftojë menjëherë organin ose personin përgjegjës apo hierarkisht epror, si dhe duhet të kufizohet nga shqyrtime apo vendime të mundshme që kanë të bëjnë me të.

### **Neni 16**

#### **Përdorimi i burimeve të universitetit**

1. Anëtarët e universitetit duhet të përdorin burimet e Ugj-së në mënyrë të përgjegjshme dhe të duhur, në mënyrë që të mund të justifikojnë shpenzimet dhe të japin dokumentacionin apo informacionin e nevojshëm, me kërkesën e universitetit.
2. Asnjë anëtar i nuk i lejohe të përdorë apo t'u lejojë personave apo enteve të jashtme pajisje të kërkimit, hapësira apo burime njerëzore, materiale ose financiare të universitetit, për qëllime të natyrës personale dhe/ose për qëllime të ndryshme nga ato të institucionit.



universitar, apo në çdo rast jo shprehimisht të aprovuara nga ky i fundit.

#### **Neni 17**

##### **Përdorimi i emrit dhe i reputacionit të universitetit**

1. Të gjithë anëtarët e universitetit duhet të respektojnë emrin e mirë dhe reputacionin e universitetit.
2. Me përjashtimin kur ka autorizim të shprehur, asnjë anëtar i të universitetit nuk i lejohej:
  - a. të përdorë në mënyrë jo të duhur logon dhe emrin e universitetit;
  - b. të përdorë reputacionin e universitetit në lidhje me veprimtari profesionale, punësime, detyra, apo veprimtari të tjera të jashtme, edhe jo të paguara;
  - c. të shprehë pikëpamje ngushtësisht personale duke përdorur emrin e universitetit.

#### **Neni 18**

##### **Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale**

1. Në përpunimin e të dhënave personale, Ugj siguron respektimin e të drejtave, lirive themelore dhe dinjitetit të personave në fjalë. Ai kërkon që anëtarët e komunitetit universitar të përdorin të dhënat në lidhje me veprimtarinë e universitetit brenda roleve që ata kryejnë dhe në përputhje me sekretin profesional, duke siguruar konfidencialitetin e çdo informacioni të marrë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Universiteti merr përsipër të sigurojë drejtpeshimin midis lirive themelore personale dhe nevojës për të matur dhe monitoruar veprimtaritë institucionale.

### **KREU V**

#### **KOMUNIKIMI INSTITUCIONAL DHE PUBLIKIMI I LIRË DHE I HAPUR I TË DHËNAVE INSTITUCIONALE**

#### **Neni 19**

##### **Komunikimi i brendshëm dhe institucional**

1. Me qëllim raportimin institucional për palët e interesuara, duke shfrytëzuar instrumentet përkatëse, Universiteti promovon imazhin, identitetin, vlerat si dhe funksionet institucionale dhe veprimtaritë brenda dhe jashtë universitetit.
2. Ugj menaxhon marrëdhëniet me palët e treta sipas parimeve të transparencës dhe korrektësisë. Informacioni dhe komunikimi për/me palët e treta duhet të jetë i vërtetë, i plotë, i qartë dhe i shpërndarë në përputhje me udhëzimet dhe aktet e brendshme të Ugj-së.

#### **Neni 20**

##### **Publikimi i të dhënave**

1. Të vetëdijshëm për rëndësinë shoqërore të kërkit, Ugj mbështet dhe nxit të gjitha forcat



përhapjes së njohurive dhe rezultateve shkencore në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit.

2. Universiteti mbështet publikimin e të dhënave jo vetëm përmes komunikimit shkresor dhe elektronik, por edhe përmes qasjes në arkivat institucionale për konsultim dhe ripërdorim të mundshëm të literaturës shkencore dhe rezultateve të kërkimit, brenda kufijve të ligjeve që mbrojnë trashëgiminë kulturore, pronësinë intelektuale, konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

#### **Neni 21**

##### **Shprehja e lirë e mendimit kritik**

1. Universiteti lehtëson mundësitë për debat dhe njeh lirinë e mendimit dhe shprehjes, madje edhe aty ku gjykimi është kritik, në mënyrë që të garantojë përmbushjen e plotë personale pa cenuar dispozitat e nenit 17 të këtij Kodi.

### **KREU VI**

#### **MARRËDHËNIET E BASHKËPUNIMIT**

#### **Neni 22**

##### **Marrëdhëniet ndërkombëtare**

2. Universiteti njeh rëndësinë e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe kontributin e tyre në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe lirisë akademike. Ai merr përsipër të promovojë një kontekst të përshtatshëm institucional për nxitjen e shkëmbimeve të ndërsjellëta dhe dimensionin ndërkombëtar të kërkimit dhe edukimit.
3. Personeli i Ugj-së bashkëpunon me komunitetin shkencor ndërkombëtar nëpërmjet projekteve kërkimore, arsimore dhe "rritjen e kapaciteteve". Në zbatimin e këtyre projekteve, ata përmbushin rolin e tyre institucional në mënyrë korrekte dhe të qartë, duke koordinuar veprimtaritë e tyre me zyrat përkatëse të administratës së Ugj.
4. Ugj nxit lëvizshmërinë ndërkombëtare të studentëve të saj me qëllim rritjen e cilësisë së të nxëniet dhe garanton njohjen e plotë të veprimtarive mësimore të ndërmarra jashtë vendit, në përputhje me marrëveshjet paraprake të nënshkruara nga palët e interesit. Ai miraton politika dhe veprime që synojnë promovimin e mundësive të barabarta në lëvizshmërinë ndërkombëtare.
5. Personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ që është pjesë e mobiliteteve ndërkombëtare, është i detyruar të ndajë përvojat dhe njohuritë e partnerëve të huaj në strukturat e veta të Ugj-së. Ata duhet të respektojnë format e ndryshme të organizimit të universiteteve partnere dhe të promovojnë imazhin dhe emrin e Ugj-së jashtë vendit.
6. Ugj bashkëpunon me partnerët ndërkombëtarë sipas parimit të trajtimit të barabartë, duke shkëmbyer dhe përfituar nga përvojat shkencore dhe mësimore. Në realizimin e veprimtarive shkencore, të seminareve dhe projekteve kërkimore, apo dhe të aktiviteteve të tjera institucionale të ndërmarra në vendet partnere, Ugj punon sipas parimeve të vendosura nga organizatat ndërkombëtare. Personeli dhe studentët e Ugj-së veprojnë në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe kodet përkatëse të sjelljes dhe etikës.



**PJESA II**  
**RREGULLAT E SJELLJES GJATË VEPRIMTARIVE MËSIMORE, KËRKIMORE**  
**DHE ADMINISTRATIVE**

**Neni 23**

**Përgjegjësitë e stafit mësimdhënës gjatë procesit mësimor**

Punonjësi i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, gjatë kryerjes së detyrës duhet të udhëhiqet nga parimi i përpikmërisë, korrektësisë, ndershmërisë, mirësjelljes, vullnetit të mirë, bashkëpunimit, solidaritetit, moralit të lartë dhe objektivitetit. Punonjësi i UGJ-së duhet:

1. Anëtarët e komunitetit universitar marrin përsipër të kryejnë veprimtaritë e tyre mësimore në përputhje me organizimin dhe planifikimin e përgjithshëm të strukturave përkatëse të Ugj-së.
2. Stafit akademik është i detyruar të përmbushë me përgjegjësi dhe korrektësi rolin e tij edukativ, duke mbështetur rritjen akademike dhe kulturore të studentëve nëpërmjet mekanizmave dhe veprimtarive shkencore të garantuara dhe të mbështetura edhe nga parimet e Kartës Evropiane të të Drejtave të Studentëve.
3. Vlerësimi i studentëve bëhet sipas procedurave të miratuara në Rregulloren e Ugj-së, për të cilat studentët njoftohen paraprakisht. Ky vlerësim kryhet në përputhje me nevojat e programeve lëndore të miratuara në programin e studimit. Këshillimi i studentëve për çështje të mësimdhënies dhe të nxënies në kohën dhe vendin e përcaktuar brenda mjediseve të Ugj-së, është pjesë thelbësore e detyrave akademike të stafit mësimdhënës. Çdo veprimtari tjetër e ngjashme, e kryer kundrejt një shpërblimi material nga ana e palëve të interesuara, konsiderohet shkelje sipas përcaktimeve të këtij Kodi.
4. Stafit akademik i Ugj-së duhet të përdorë gjuhën zyrtare dhe një fjalor të përshtatshëm, brenda normave të etikës së komunikimit dhe të sjelljes qytetare.
5. Stafit akademik i Ugj-së duhet të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve të larta, apo favore e përfitime të tjera të cilat anëtari i personelit akademik mund t'i kryejë për shkak të detyrës. Identifikimi i rasteve të tilla ndëshkohet sipas procedurave të Kodit Penal të RSH.
6. Stafit akademik duhet të mos bëjë dhe të mos bëhet pre e provokimeve, ngacmimeve të të gjitha formave nga studentët apo personat e tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë Kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me normat morale.

**Neni 24**

**Detyrime të tjera të personelit**

Çdo anëtar i personelit të Ugj-së duhet:

1. të promovojë interesat më të mira të Universitetit;
2. të punojë për realizimin e misionit, vizionit dhe vlerave të Universitetit;
3. të ruajë respektin dhe besimin e publikut ndaj Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë,



- dhe integritetin e tij;
4. të shfaqë integritet personal, ndershmëri dhe përgjegjësi në të gjithë veprimet e tij.
  5. të sigurojë një mjedis të respektit reciprok, të paanshmërisë dhe të bashkëpunimit.
  6. të ruajë konfidencialitetin e të gjitha çështjeve sipas parashikimeve të bëra në ligj. g. të sigurojë zgjidhje të pavarura të çështjeve.
  7. të sigurojë që marrëdhëniet të cilat janë ose mund të perceptohen si konflikte interesi, të jenë plotësisht të hapura dhe të ndiqen nga udhëzimet e organeve kolegjiale të Ugj-së.
  8. të ketë përputhshmëri me politikat dhe procedurat e Ugj-së dhe ligjet në fuqi.
  9. të demonstrojë përkujdesje ndaj pronës dhe burimeve të Universitetit.
  10. të respektojë orarin e punës, sipas kontratës së punës.
  11. të paraqitet me veshje serioze në përshtatje me funksionin që kryen. Veshja e personelit të universitetit duhet të përmbushë standardet e profesionalizmit dhe të modestisë, pa u bërë shkak debati dhe tërheqje vëmendjeje. m. të zbatojë me korrektësi detyrën dhe urdhrat e eprorit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. n. të shmangë rastet kur ka konflikt interesash sipas legjislacionit në fuqi, duke i deklaruar ato përpara eprorit sapo të jenë shfaqur.
  12. të mos lejojë që interesat personale të prekin marrëdhëniet profesionale.
  13. të mos bëjë dallime midis studentëve, vartësve apo kolegëve për shkak të njohjeve apo parapëlqimeve vetjake.
  14. të trajtojë në mënyrë të barabartë vartësit, kolegët dhe studentët, duke shmangur cenime të dinjitetit, të personalitetit dhe të mendimeve të tyre profesionale pavarësisht mospërputhjes së mendimeve dhe/ose interesave.
  15. të mos konsumojë pije alkoolike apo duhan në mjediset e brendshme të institucionit.
  16. të mos përgojë, të mos shpifë e të mos njollosë imazhin profesional e personal të anëtarëve të tjerë të personelit të Universitetit.
  17. Të respektojë orarin e punës të vendosur nga punëdhënësi.
  18. Të ruajë një paraqitje serioze përpara studentëve dhe personave të tjerë, gjatë orarit të punës, që përfshin veshje serioze e dinjitoze, përdorimin e një fjalori të zgjedhur dhe brenda normave të etikës e të sjelljes qytetare.
  19. të zbatojë me korrektësi detyrën dhe urdhrat e eprorit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.
  20. të shfaqë sjellje të mirë, brenda normave të etikës qytetare e profesionale ndaj studentëve.
  21. të shmangë rastet kur ka konflikt interesash sipas legjislacionit në fuqi, duke i deklaruar ato përpara eprorit, sapo të jenë shfaqur.
  22. të mos lejojë që marrëdhëniet personale të prekin dhe të mos krijojnë përshtypjen se prekin marrëdhëniet profesionale. Ai duhet të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve të larta, apo favore të tjera të cilat pedagogu mund t'i kryejë për shkak të detyrës.
  23. të mos bëjë dallime ndër studentë, vartës apo kolegë për shkak të njohjeve apo preferencave personale.



24. të mos bëjë dhe të mos bëhet pre e provokimeve, ngacmimeve të të gjitha formave nga studentë apo persona të tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë Kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me normat morale.
25. të kujdeset për pasurinë e institucionit dhe të mos e përdorë atë për përfitime personale. Kur ndërmerret punë konsulente private, pedagogu duhet të mos përdorë autoritetin që ka dhe të mos veprojë në emër të universitetit, si dhe të mos përdorë burimet pasurore publike të tij në aktivitetin privat.
26. të trajtojë në mënyrë të barabartë vartësit, kolegët dhe studentët, duke shmangur cënime të dinjitetit, të personalitetit dhe të mendimeve të tyre profesionale.
27. Të mos konsumojë pije alkoolike apo duhan në ambientet e institucionit.

## Neni 25

### Përgjegjësitë dhe të drejtat e studentëve

1. Studentët në ambientet e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, duhet:
  - a. të zbatojnë orarin e mësimit dhe t’u përmbahen rregullave të sanksionuara në Statutin dhe në Rregulloren e Universitetit “Eqrem Çabej”.
  - b. të paraqiten në mënyrë serioze në mjediset e institucionit, që përfshin një veshje të përshtatshme dhe dinjitoze, si dhe përdorimin e një fjalori në përputhje me normat e etikës së komunikimit dhe sjelljes qytetare.
  - c. të respektojnë personelin akademik, ndihmës akademik dhe personelin administrativ, shokët dhe rregullat e mësimit. T’u drejtohen personelit akademik dhe atij administrativ në vetën e dytë shumës si edhe me titujt akademikë përkatës.
  - d. të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese apo ngacmuese ndaj personelit akademik apo studentëve të tjerë në mjediset e institucionit.
  - e. të mos ofrojnë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, vetë apo nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta, apo favorizime të tjera, të cilat lektori apo anëtarë të tjerë të personelit të Universitetit mund t’i kryejnë për shkak të detyrës.
  - f. të mos kopjojnë, të mos kryejnë akte që dëmtojnë procesin mësimor si dhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve akademike.
  - g. të mos konsumojnë pije alkoolike apo duhan në mjediset e brendshme të institucionit.
  - h. të mos përdorin celular dhe ta mbajnë atë të fikur gjatë orarit të mësimit ose provimit në auditor, me përjashtim të rasteve kur nevojitet për qëllime didaktike.
  - i. studentit, i cili përfshihet në një veprim të ndaluar apo thyrje ligji, i cili rezulton në prishjen e orës së mësimit, mund të drejtohet nga pedagogu të lerë auditorin për periudhën e mbetur të orës së mësimit. Për përjashtime më të gjata si pasojë e prishjes së orës së mësimit duhet të merren vendime me shkrim nga organet përkatëse.
2. Si anëtarë të Universitetit “Eqrem Çabej”, studentët gëzojnë të drejtat dhe liritë si vijon:
  - a. Çdo student ka të drejtën të jetë i lirë nga diskriminimi racor, fetar, etnik, përkatësia politike, mosha, gjinia dhe aftësitë e kufizuara.
  - b. Studentët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, të mbledhjes dhe grupimeve për aq kohë



- sa shfrytëzimi i këtyre lirive pajtohet me politikat e universitetit, nuk ndërhyt në funksionimin normal të programeve të studimit dhe respekton të drejtat e të tjerëve.
- c. Studentët janë të lirë të organizojnë dhe marrin pjesë në organizata studentore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të promovuar interesin e tyre të përbashkët brenda universitetit. Organizatat studentore janë të lira të shqyrtojnë dhe diskutojnë të gjitha çështjet e interesit, në zbatim me rregulloren e Universitetit. Organizatat e njohura dhe të pranura mund të gëzojnë privilegjin të përdorin godinat, lehtësirat dhe shërbimet e Universitetit sipas politikave dhe procedurave administrative të Universitetit.
  - d. Studentët kanë të drejtën të jenë të lirë nga çdo lloj ngacmimi nga anëtarët e komunitetit të Universitetit. Studentët kanë të drejtën dhe përgjegjësinë të raportojnë, në mirëbesim dhe pa frikë hakmarrjeje, çdo shkelje të këtij kodi apo politike të Universitetit tek Këshilli i Etikës, drejtuesit akademikë apo administrativë të Universitetit.
3. Studentët e akuzuar për shkeljen e këtij Kodi kanë të drejtat e mëposhtme:
- a. të kenë në dispozicion të gjitha politikat dhe procedurat e Universitetit lidhur me funksionimin e procesit disiplinor.
  - b. të vihen në dijeni dhe të sqarohen, siç kërkohet, për akuzat e mbetura pezull.
  - c. të jenë të lirë nga kërcënimet e personelit të Universitetit në zgjidhjen e çështjes disiplinore.
  - d. të përballen me akuzuesin/it dhe të kenë mundësi të ripyenin ata/ndonjë dëshmitar të pranishëm. e. të jenë të lirë nga kontrollet apo konfiskimet, përjashtuar rasteve kur këto bazohen në shkaqe të arsyeshme dhe nga zyrtarët përkatës.

## Neni 26

### Sjelljet e ndaluara të studentëve

1. Sjelljet e ndaluara përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në sa më poshtë:
  - a. Ndërhyrje apo përçarje që pengon dhe dëmton misionin e Universitetit, proceset ose funksionet që shkelin të drejtat e të tjerëve. Veprat penale përfshirë këtu janë: bllokimi i çfarëdo ndërtese të Universitetit ose pasurie, ose pjesë të tyre, pa autorizimin e Universitetit; bllokimi i hyrjes apo daljes së ndonjë ndërtese të Universitetit; vendosjen e zjarrit ose me ndonjë mjet tjetër, duke dëmtuar ndërtesën, pronën apo pasurinë universitare.
  - b. Përdorimi, apo shpërndarja e substancave narkotike ose të rrezikshme, me përjashtim kur lejohet shprehimisht me ligj. Universiteti ndalon mbajtjen, përdorimin, shitjen ose shpërndarjen e substancave të paligjshme apo substancave të pakontrolluara.
  - c. Sjellja jo e rregullt, abuzive, e dhunshme ose shprehje tepër e zhurmshme, çdo përpjekje apo kërcënim i paramenduar me synimin lëndimin e personit tjetër, së bashku me aftësinë e dukshme për ta bërë këtë, është e ndaluar. Një sjellje jo e rregullt mund të kryhet edhe pa prekur, goditur, apo bërë dëm trupor. Në varësi të rrethanave, një faktor lehtësues për këtë akuzë mund të jetë vetëmbrojtja.
  - d. Kërcënimimi apo ushtrimi i dhunës fizike.
  - e. Zbatimi i programeve apo veprimtarive që përbëjnë shkelje të së drejtës vendore ose



shtetërore dhe politikave të Universitetit. Studentët janë të ndaluar të flasin në emër të Ugj-së me ndonjë organizatë të medias së folur apo të shkruar. Studentët janë të ndaluar të ftojnë në ambientet apo veprimtaritë e Universitetit organizata të mediave, përjashtuar rastet kur merret leje me shkrim nga autoritetet drejtuese. Studentët, si individë ose përfaqësues të organizatave studentore, janë të ndaluar të hyjnë në marrëveshje verbale, me shkrim ose në kontrata që kanë për qëllim të lidhin, detyrojnë ose krijojnë ndonjë lloj përgjegjësie për Ugj-në. Universiteti do të njohë gjithë këta studentë individualisht përgjegjës për pasojat financiare, juridike ose dëmet që mund të rezultojnë nga veprime të tilla të paautorizuara.

- f. Pengimi i një anëtari të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ për të përmbushur detyrat dhe funksionet e tij të përcaktuara në aktet e brendshme të Ugj-së apo edhe në dispozitat ligjore në fuqi.
- g. Falsifikimi ose manipulimi i shkresave dhe dokumentave zyrtare të Universitetit, përdorimi i dokumentave dhe të dhënave zyrtare të Universitetit për qëllime keqinterpretimi. Përdorimi i telekomunikacionit, rrjetit të të dhënave ose ndonjë pajisjeje elektronike në pronësi dhe administrim të Universitetit për qëllime të paligjshme/të pahijshme, në shkelje të rregullores, politikave të Universitetit ose ligjeve, është e ndaluar.
- h. Çdo veprim i ndërmarrë apo situatë e krijuar, me dashje ose nga pakujdesia, duke krijuar probleme në mbarëvajtjen e veprimtarive të Universitetit. Këto veprime përfshijnë, por nuk kufizohen në:
  - I. kopjimin e përgjigjeve nga një student tjetër gjatë provimit;
  - II. komunikimin e paautorizuar me të tjerët gjatë një provimi;
  - III. lejimin e një studenti tjetër të kopjojë përgjigjet;
  - IV. zëvendësimin e një personi tjetër ose përdorimin e një tjetri si zëvendësues gjatë një provimi;
  - V. programimin paraprak të një makine llogaritëse apo pajisjeve të tjera elektronike që mbajnë përgjigje ose informacion të paautorizuar për provim;
  - VI. përdorimin e materialeve të paautorizuara, përgjigjeve të parapërgatitura, shënimeve të shkruara apo informacionit të fshehur gjatë një provimi;
  - VII. lejimin e të tjerëve të bëjnë për ta një detyrë apo pjesën e një detyre (psh. detyrën e grupit), përfshirë përdorimin e shërbimit komercial të punimeve (blerjen e tyre); dorëzimin e së njëjtës detyrë në më shumë se një kurs pa miratimin paraprak të të gjithë pedagogëve të përfshirë.
  - VIII. ofrimin ose dhënien e mitës personelit të Universitetit ose atyre që mbajnë pozicione drejtuese;
  - IX. mospagimin e detyrimeve financiare ndaj Universitetit.
  - X. Përvetësimin e paautorizuar të aseteve ose shërbimeve brenda Universitetit.
  - XI. mbajtjen pa leje të armëve të zjarrit ose armëve të ftohta (armë të modeleve dhe llojeve të ndryshme, mjete shpërthyes, lëndë plasëse, thikat etj.) që përbëjnë rrezik për mirëqenien e anëtarëve të komunitetit universitar.
  - XII. Zotërimin, përdorimin, ruajtjen ose transportimin e armëve të zjarrit, eksplozivit, fishekzjarreve apo kimikateve të rrezikshme, përjashtuar mjetet



apo lëndët për të cilat ekziston autorizimi për përdorim në klasë.

- i. Prishja, dëmtimi ose shkatërrimi i pronës publike ose private. Hyrja ose përdorimi i objekteve pronë e Universitetit ose pronave në ruajtje kontroll të Universitetit, për një qëllim të pahijshëm, pa autorizimin e duhur ose duke ndihmuar të tjerët të veprojnë kështu.
- j. Dëshmia e rremë ose fshehja e evidencave përballë Organeve Kolegjiale ose anëtarëve të personelit të Universitetit. Raportimi i rremë për praninë/kanosjen e një bombe, pajisjeje apo situatë tjetër rreziku. Njohja dhe mosraportimi i një ngjarjeje/akti që rrezikon anëtarët e Universitetit. Realizimin e përgënjeshtimeve në materiale nën kontekstin e një detyre akademike; ndryshimin e informacionit ose të dhënave dhe paraqitjen e tyre si të ligjshme; dhënien e informacionit të rremë/mashtrues për një pedagog apo zyrtar të Universitetit; sabotimin apo vjedhjen e detyrës, librit, punimit, shënimeve, eksperimentit, projektit, softëare apo hardëare elektronik të një personi tjetër; marrjen e një kopjeje provimi ose detyre përpara lëshimit të miratuar nga pedagogu; shitjen, shpërndarjen, postimin në ëbsite, apo botimin e shënimeve të leksioneve, prospekteve, recencave, regjistrimeve ose informacioneve të tjera të dhëna nga një pedagog apo përdorimi i tyre për qëllime komerciale, pa lejen e pedagogut; falsifikimin e nënshkrimit në një letër rekomandimi ose ndonjë dokumenti tjetër të një pedagogu; vënien e emrit të një personi në provimin apo detyrën e një personi tjetër; ndryshimin e një provimi apo detyre të vlerësuar me parë për qëllime të një apelimi note apo për të fituar pikë në një proces rivlerësimi. Plagjiatura është shkelje e Kodit të Etikës Studentore referuar Nenit 7 të këtij Kodi,
- k. Ngacmime të çdo lloji ndaj personelit ose studentëve të Universitetit. Angazhimi i një sjelljeje në formë verbale, elektronike, vizuale, të shkruar ose trupore (fizike) ndaj një individi apo grupi individësh që ka të ngjarë të provokojë/rezultojë në një reagim negativ, dëmtues dhe në një stres mendor apo emocional. Kjo sjellje mund të përfshijë:
  - I. kërcënimin direkt apo të nënkuptuar me pasoja në veprimtarinë universitare të anëtarëve të tjerë të Universitetit, në veprimtaritë e sponsorizuara nga Universiteti, organizatat ose grupet universitare.
  - II. krijimin e një situatë/mjedisi frikësues ose poshtëruës, shkaktimin e dëmeve personale, sociale, akademike, psikologjike, emocionale apo stresi të panevojshëm.
- l. Pjesëmarrja ose organizimi në veprimtari bastesh brenda mjediseve të Universitetit. Pjesëmarrja në demonstrata, trazira apo veprimtari që prishin funksionimin normal të Universitetit dhe/ose shkelin të drejtat e të tjerëve ose udhëheqja apo nxitja që anëtarët e tjerë të prishin veprimtaritë normale dhe/ose të planifikuara.
- m. Dhunimi i rregulloreve ose politikave të përcaktuara nga Universiteti, të cilat përfshijnë:
  - I. përdorimin e paautorizuar ose dhunimin e pajisjeve kompjuterike, pirjen e alkoolit, duhanit në mjediset e brendshme të Universitetit, hyrjen, përdorimin ose dhunimin e



- paautorizuar të pajisjeve dhe mjediseve fizike të Universitetit.
- II. vjedhjen ose tentativën për vjedhje të pronës dhe/ose shërbimeve të Universitetit;
  - III. mbajtjen ose transportimin e vetëdijshëm të pasurisë së vjedhur; përdorimin ose konvertimin e papërshtatshëm të pronës së një tjetri për përdorim vetjak.
  - IV. vjedhjet e identitetit.
  - V. Hakmarrja ose përndjekja e drejtpërdrejtë ose jo pas marrjes së ndonjë vendimi kundrejt anëtarëve të Këshillit të Etikës apo organi tjetër të përfshirë në çështje. Përndjekja është përkufizuar si ndjekja dhe ngacmimi i qëllimshëm, dashakeqës dhe i përsëritur i një personi që shkakton ndjenjën e frikës, kërcënimit, ngacmimit ose dhunimit. Përndjekja është sjellja e një studenti i cili mban një qëndrim të përsëritur ndaj një personi tjetër dhe krijon një kërcënim të besueshëm me qëllim frikësimin për sigurinë e tij ose të familjes së tij. Përndjekja mund të jetë fizike ose në adresat elektronike zyrtare.
  - n. Kërcënimet, abuzimet ose dhuna verbale, fizike dhe seksuale.
  - o. Tentativat për të kryer aktet e parapërmendura ose bashkëpunimi në aktet e parapërmendura.

## Neni 27

### Përgjegjësitë në veprimtaritë kërkimore

1. Veprimtaria kërkimore- shkencore ngrihet mbi parimin e lirisë akademike, e cila garantohet nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar çështjet e kërkimit, për të zhvilluar teori, për të grumbulluar të dhëna empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme. Veprimtaria kërkimore-shkencore zhvillohet në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim negativ mbi kërkimin dhe rezultatet e tij si edhe nga ndikimet ideologjike, politike, ekonomike, teknologjike, ose nga ndryshimet në mjedisin e kërkimit.
2. Parimet themelore të integritetit të kërkimit orientojnë kërkuesit në punën e tyre dhe angazhimin e tyre ndaj sfidave praktike, etike dhe intelektuale që shoqërojnë ose burojnë nga kërkimi shkencor. Këto parime janë:
  - a. garancia për cilësinë e kërkimit;
  - b. ndershmëria në zhvillimin dhe në komunikimin e rezultateve me transparencë, drejtësi dhe paanshmëri;
  - c. respekti për kolegët;
  - d. kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin; e. përgjegjësia shoqërore për kërkimin.
3. Kërkimi shkencor udhëhiqet nga modeli i praktikave më të mira, të cilat përfshijnë aspektet e mëposhtme:
  - a. mjedisin e kërkimit;
  - b. trajnimin për kërkimin;
  - c. udhëheqjen e kërkimit dhe të studiuesit;
  - d. procedurat e kërkimit; e. mbrojtjen e studiuesit;
  - e. përdorimin e të dhënave;
  - f. punën në skuadër dhe bashkëpunimin;



- g. botimin e rezultateve të kërkimit;
  - h. vlerësimin e kërkimit.
4. Shkelje të integritetit në kërkimin shkencor, përbëjnë praktikat e mëposhtme:
- a. manipulimi i autorësisë ose denigrimi i rolit të kërkuesve të tjerë në botime;
  - b. ribotimi i pjesëve thelbësore të botimeve të veta më të hershme si të reja (autoplagjiatura);
  - c. citimi përzgjedhës, me qëllim për të zmadhuar gjetjet e veta ose të redaktorëve, drejtuesve ose të kolegëve;
  - d. fshehja e pjeshme e rezultateve të kërkimit;
  - e. lejimi i financuesve/sponsorizuesve të rrezikojnë pavarësinë e procesit të kërkimit ose të raportimit të rezultateve, me qëllim krijimin e kuptimeve të njëanshme ose të paplota;
  - f. zgjerimi në mënyrë të panevojshme i bibliografisë së studimit;
  - g. akuzimi me keqdashje i studiuesve të tjerë për sjellje të papranueshme ose shkelje të tjera;
  - h. zmadhimi i pajustificuar i rëndësisë dhe i zbatueshmërisë praktike të gjetjeve të kërkimit;
  - i. vonimi ose pengimi i punës së kërkuesve të tjerë;
  - j. keqpërdorimi i pozitës më të lartë për të inkurajuar shkelje të integritetit kërkimor;
  - k. fshehja e shkeljeve të mundshme të integritetit kërkimor të kryera nga persona të tjerë ose qëndrimet e papërshtatshme ndaj sjelljeve që shkelin Kodin e Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, si dhe të shkeljeve të tjera të kryera nga institucionet;
  - l. themelimi ose mbështetja e revistave a botimeve të tjera grabitqare që minojnë kontrollin e cilësisë së kërkimit;
  - m. fshehja e konfliktit të interesit;
  - n. shkelje të tjera etike të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

## Neni 28

### Shërbimet administrative

1. Për të përmbushur përgjegjësitë administrative dhe ato të auditit, instancat përkatëse duhet të jenë të pavarura dhe të garantojnë objektivitet.
2. Është shkelje e kodit të Etikës së Universitetit të mashtrorsh, të japësh informacion të rremë apo të heqësh qëllimisht materiale, si dhe fakte nga auditit. Shërbimet administrative dhe ato të auditit kategorizohen sipas pozicioneve dhe normave etike institucionale që ata duhet të zbatojnë në përputhje me përgjegjësitë dhe profilin e tyre të punës.
3. Personeli akademik duhet të zbatojë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha përgjegjësitë administrative që i janë përcaktuar. Personeli akademik duhet të:
  - I. përgatit tezat e provimeve, procesverbalet dhe të ruajë dokumentacionin e provimeve në mënyrë korrekte sipas rregullores së fakulteteve përkatëse.
  - II. personeli akademik që drejton lëndën dhe kolegu asistues në provim duhet të tregojnë etikë, paanshmëri dhe rigorozitet në rastet kur janë konstatuar parregullsi gjatë provimit.



- III. përveç mësimdhënies, duhet të respektojnë detyrat institucionale që mund t'u lindin duke përfshirë transferimin e teknologjisë, organizimin e veprimtarive shkencore dhe angazhimin në veprimtari mbështetëse për institucionin, si dhe në pozicione drejtuese dhe këshilluese. iv. në raste të veçanta, me kërkesë të institucionit, ata duhet të angazhohen në veprimtari auditimi të brendshëm për të siguruar etikë, cilësi dhe barazi.
  - IV. respektojnë kolegët, personelin ndihmësakademik, administrativ dhe studentët. T'u drejtohen kolegëve në vetën e dytë shumës sipas rastit.
  - V. të tregojnë kujdes për të mos nëpërkëmbur dinjitetin dhe personalitetin e studentëve.
4. Personeli ndihmësakademik me karakter akademik (laborantët) duhet të zbatojnë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha përgjegjësitë ndihmëse mësimore-shkencore që u janë caktuar.
- I. Duhet të mirëmbajnë dhe të auditojnë kabinetet laboratorike gjatë orarit zyrtar të punës.
  - II. Duhet të përgatisin laboratorët përpara fillimit të mësimin.
  - III. Duhet të kontrollojnë laboratorët dhe të asistojnë pedagogët përgjatë orës së mësimin.
  - IV. Duhet të kryejnë një inventarizim të pajisjeve fizike në përfundim të çdo ore mësimi.
  - V. Duhet të raportojnë raste të shkeljes së rregullave të laboratorit dhe dhunës fizike mbi pajisjet laboratorike nga ana e studentëve.
  - VI. Të respektojnë kolegët dhe personelin akademik. T'u drejtohen personelit akademik në vetën e dytë shumës.
  - VII. Të tregojnë kujdes për të mos nëpërkëmbur dinjitetin dhe personalitetin e studentëve.
5. Personeli ndihmësakademik me karakter akademik (teknikët TI) duhet të zbatojnë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha përgjegjësitë administrative dhe të auditimit që u janë përcaktuar.
- I. Duhet të kujdesen për sigurinë e konfidencialitetin, integritetin dhe cilësinë e infrastrukturës dhe sistemeve të TI brenda institucionit.
  - II. Duhet të bashkërendojnë periodikisht me personelin ndihmës kërkimor shkencor, procesin e auditimit dhe inventarizimin e laboratorëve.
  - III. Duhet të raportojnë periodikisht tek eprori mbi gjendjen aktuale të pajisjeve të TI, si dhe të sugjerojnë ndryshime e përmirësime të sistemit aktual të informacionit dhe teknologjisë. Ata janë përgjegjës për zbatimin e projekteve që u ngarkohen.
  - IV. Duhet të mbledhin dhe të ruajnë e të mos fshehin evidencat elektronike që vërtetojnë akte joetike gjatë komunikimeve elektronike.
  - V. Duhet të përgatisin materiale orientuese për personelin e Universitetit dhe t'i asistojnë në raste emergjencash.
  - VI. Të respektojnë kolegët dhe personelin akademik. T'u drejtohen personelit akademik në vetën e dytë shumës.



6. Personeli administrativ duhet të zbatojë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha përgjegjësitë administrative që u janë përcaktuar.
  - I. Duhet të mirëmbajnë dhe auditojnë mjedisin dhe objektet fizike, të cilat i kanë në ngarkim.
  - II. Duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, me personelin akademik dhe ndihmës akademik për mbarëvajtjen e punës.
  - III. Duhet të raportojnë tek eprori në rastet kur kanë konstatuar parregullsi ose akte joetike dhe të ruajnë e të mos fshehin evidencat që i vërtetojnë ato.
  - IV. Në raste të veçanta, me kërkesë të institucionit, ata duhet të angazhohen në veprimtari auditimi të brendshëm.
  - V. Të respektojnë kolegët dhe personelin akademik. T'u drejtohen personelit akademik në vetën e dytë shumës si edhe me titujt akademikë përkatës.
7. Sekretaritetë mësimore dhe sekretaritetë e departamenteve duhet të zbatojnë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha përgjegjësitë administrative dhe të auditimit që u janë përcaktuar.
  - I. Duhet të kujdesen për sigurinë e konfidencialitetin, integritetin dhe cilësinë e punës brenda sekretarive të fakultetit përkatës.
  - II. Duhet të mbikëqyrin regjistrat, procesverbalet si dhe dokumentat elektronike që gjenden në sekretaritetë përkatëse.
  - III. Duhet të asistojnë pedagogët përpara dhe gjatë dorëzimit të procesverbaleve dhe provimeve.
  - IV. Duhet të bëjnë njoftime me shkrim në lidhje me ndryshime që ndikojnë procesin mësimor dhe pedagogët.
  - V. Duhet të raportojnë tek eprori në lidhje me punët që u janë ngarkuar dhe problemet që mund të shkaktohen. Nuk duhet të fshehin parregullsitë e evidentuara që kanë të bëjnë me çështje etike.
  - VI. Duhet të përgatisin materiale ndihmëse për personelin akademik në lidhje me procesverbalet, tezat e provimeve dhe rregulloret të tjera.
  - VII. Duhet të asistojnë personelin akademik gjatë shumëfishimit të tezave të provimit.
  - VIII. Të respektojnë koleget dhe personelin akademik. T'u drejtohen personelit akademik në vetën e dytë shumës si edhe me titujt akademikë përkatës.
  - IX. Të respektojnë studentët dhe të ruajnë një sjellje korrekte kundrejt tyre, në përputhje me rregullat etike e morale, pa cënuar dinjitetin personal të ndonjë individi.
8. Drejtuesit e njësive akademike dhe administrative duhet të zbatojnë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha përgjegjësitë administrative dhe të auditimit që u janë përcaktuar.
  - I. Duhet të sigurojnë ruajtjen e normave etike institucionale brenda njësisë që drejtojnë.
  - II. Duhet të mbikëqyrin punën dhe aktivitetin që zhvillon njësia që drejtojnë.
  - III. Duhet të jenë transparentë dhe të paanshëm në procesin e punësimit, drejtimit dhe auditimit për të siguruar cilësi, barazi dhe etikë në mjedisin e Universitetit, duke përjashtuar interesat apo konfliktet vetjake.
9. Organet kolegjiale duhet të zbatojnë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha përgjegjësitë administrative dhe të auditimit që u janë përcaktuar.
  - i. Duhet të sigurojnë ruajtjen e normave etike dhe institucionale, duke hartuar rregulloret



- dhe Kodin e Etikës në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.
- ii. Duhet të jenë transparentë dhe të paanshëm gjatë procesit të hartimit të rregulloreve duke përjashtuar interesat apo konfliktet vetjake.
  - iii. Duhet të mbikëqyrin punën dhe veprimtarinë që zhvillon universiteti dhe të këshillojnë në rastet kur vërehen ose njoftohen për shkelje rregulloresh ose të Kodit të Etikës.

### **PJESA III MASAT DISIPLINORE**

#### **Neni 29 Sqarime dhe raportimet e shkeljeve**

1. Ashtu si të gjithë kodet, ky kod nuk do të mund të mbulojë të gjitha situatat e mundshme. Personeli dhe studentët e Universitetit pritet të raportojnë shkelje të këtij kodi për një individ të caktuar pranë Këshillit të Etikës. Janë të detyruar të gjithë drejtuesit e Universitetit, fakulteteve, departamenteve dhe drejtuesit e drejtorive të ndryshme të identifikojnë rastë të shkeljes së Kodit të Etikës së Universitetit dhe t'i raportojnë pranë Këshillit të Etikës. Çdo person që është subjekt i zbatimit të dispozitave të këtij Kodi, ka të drejtë të denoncojë apo raportojë vetë, nëpërmjet eprorit ose organeve të zgjedhura të studentëve, shkelje të dispozitave të këtij Kodi, përpara anëtarëve të Këshillit të Etikës.

#### **Neni 30 Denoncimi i shkeljes**

Secili person që është subjekt i aplikimit të dispozitave të këtij Kodi ka të drejtë të denoncojë apo raportojë vetë, nëpërmjet eprorit, ose mbrojtësit të studentëve, shkelje të dispozitave të këtij Kodi, përpara anëtarëve të Këshillit të Etikës, autoritetit drejtues të njësisë kryesore ose Rektorit, i cili merr edhe mendimin e Këshillit të Etikës.

#### **Neni 31 Llojet e masave disiplinore**

1. Përveç shkeljeve që ndëshkohen nga dispozitat e Statutit dhe të Rregullores së Ugj-së, si dhe të atyre që përbëjnë figurë veprash penale që trajtohen nga dispozitat e Kodit Penal, shkelja e dispozitave të parashikuara në këtë Kod përbën shkelje disiplinore për të cilën parashikohet:
2. Ndëshkim me “Tërheqje vëmendje”, “Vërejtje me shkrim” dhe “Vërejtje me paralajmërim për përjashtim” nga Universiteti. Në rast se këto shkelje bëhen të përsëritura, Këshilli i Etikës i propozon autoritetit drejtues, ndëshkime të tjera më të rrepta.
3. Për shkeljen në mënyrë të përsëritur të pikave 5, 6 të Nenit 23 dhe gërmave m., n., o., p., të Nenit 24 sipas rastit, parashikohet ndjekje penale, dhe/ose. procedim disiplinor deri në largim nga puna. Në rast se anëtari i personelit ka në dosjen e tij masë disiplinore për



shkeljen e ndonjeres prej pikave 21 të sipërpërmendura, atij i hiqet e drejta të kandidojë apo të rikandidojë në një pozicion të lartë administrativ. Në rast se ka patur tentativë të shkeljes së Nenit 24, anëtar i personelit nuk gëzon të drejtën të kandidojë apo rikandidojë në pozicione drejtuese ose përfaqësuese.

4. Për shkeljen e secilës prej pikave të Nenit 26 parashikohet ndëshkim me “Tërheqje vëmendjeje”, i cili i bashkohet dosjes disiplinore të studentit, nëse ai nuk ka shlyer detyrimet brenda afateve kohore. Dosja disiplinore përmban rekordet (të dhënat) e sjelljes disiplinore të studentit. Çdo student, përveç krediteve që duhet të marrë përpara se të diplomohet, duhet edhe të shlyejë detyrimet e vendosura nga Këshilli i Etikës për shkeljet që ka kryer. Detyrimet përfshijnë shlyerje detyrimi financiar për dëme materiale të shkaktuara ndaj pajisjeve apo mjediseve fizike të Universitetit, si çdo masë tjetër disiplinore të marrë nga organet përkatëse. Studenti mund të përjashtohet nga auditori drejtpërdrejt nga vetë pedagogu i lëndës për një periudhë kohe. Në rast se shkelja përsëritet, edhe pas tërheqjes së vëmendjes, studentit mund të pezullohet nga pjesëmarrja në mësim për lëndën përkatëse, deri në marrjen e një vendimi nga Dekanati.
5. Për shkeljen e pikes h. të Nenit 26, studentët do të penalizohen me 0 (zero) pikë nga provimi. Në rast se shkelja përsëritet përgjatë semestrit, studentit mund të pezullohet nga pjesëmarrja në mësim për lëndën përkatëse dhe mund të vlerësohet me notën jokaluase 4 (katër) në lëndën përkatëse deri në marrjen e një vendimi nga Dekanati sipas dispozitave të Statutit dhe të Rregullores së brendshme të Ugj-së. 6. Marrja e vendimit duhet të behet brenda 25 ditëve pune pas njohjes së Këshillit të Etikës me çështjet në shqyrtim.

### Neni 32

#### Organi disiplinor

1. Këshilli i Etikës është organi që krijohet dhe funksionon në përputhje me Nenin 44 të Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë,
2. Në zbatim të këtij Kodi, ai ka në kompetencë:
  - a. Të vëzhgojë zbatimin e dispozitave të këtij Kodi dhe të propozojë ndryshime, përmirësime apo masa të tjera detyruese që kanë të bëjnë me etikën në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë.
  - b. T’i propozojë Rektorit dhe/ose Administratorit, sipas përkatësisë, masat disiplinore të parashikuara në Nenin 30, sipas rastit.
  - c. Në rastet e proceseve zgjedhore, kur Rektori në fuqi jep dorëheqjen për të rikandiduar për pozicionin e Rektorit, vendimet për masat disiplinore që kanë të bëjnë me personelin akademik, ndihmësakademik dhe për studentët merren nga Këshilli i Etikës.
  - d. Këshilli i Etikës shqyrton vetëm rastet kur denoncimi, ankesa apo raportimi kanë të përcaktuar individin që bën ankesën.

### Neni 33

#### Mbledhja dhe funksionimi KE



Këshilli i Etikës mblidhet dhe funksionon në nivel njësie kryesore (fakulteti/qendre/drejtorie) dhe në nivel universiteti.

Këshilli i Etikës mblidhet të paktën një herë në tre muaj, por kur ka raportime apo denoncime pranë tij, apo nga ana e organeve eprorë të tjera, mund të mblidhet edhe më shpesh.

Këshilli i Etikës zhvillon mbledhjet në prani të sekretarit teknik, i cili dokumenton anën protokollare të funksionimit të tij.

Këshilli i merr vendimet me shumicë të thjeshtë dhe ua dërgon për miratim përfundimtar Dekanit/Drejtorit, ose Rektorit sipas nivelit.

Vendimet dhe masat që merren në ushtrim të funksioneve, Këshilli i Etikës i dërgon për regjistrim në zyrën e burimeve njerëzore dhe në zyrën e protokollit e arshivës.

#### **Neni 34**

#### **Dispozita përfundimtare**

1. Pjesë e Kodit të Etikës është dhe shtojca për kriteret dhe standartet për kontrollin antiplagjiature të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore në UGJ.
2. Kodi i Etikës hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik.

